



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI**

---

Numri i lëndës: 2022:028023

Datë: 18.10.2022

Numri i dokumentit: 03542153

**CP.nr.100/2022**

**Gjykata Themelore Gjilan dega e Vitisë**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditores V. Sh. A., nga fshati S., Komuna e Vitise, të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti ndaj debitorit Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shume prej 2,546.00 euro, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 17.10.2022 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

Përfundohet, procedura përmbarimore e kreditores V. Sh.A., nga fshati S.. Komuna e Vitise, të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti, në këtë çështje juridike përmbarimore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore Gjilan dega e Vitisë, kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr. 100/2022, të datës 09.02.2022, ndaj kreditores V. Sh. A. nga fshati S., Komuna e Vitise, të cilin e përfaqëson Fatos Pira, avokat në Viti, kundër debitorit Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shume prej 2,546.00 euro, sipas dokumentit përmbarues akgykimi C.nr. 555/2020 të datës 19.11.2021.

Gjykata me datën 21.09.2022, kishte pranuar parashtresën nga ana e të autorizuarit së kreditores, nga e cila parashtresë ishte konfirmuar se debitori e ka përbushur detyrimin në tërsi .

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës konstaton se janë përbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbarimore ndaj debitorit duke u bazuar në parashtresën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate .

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-ës, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2022:028023, 17.10.2022**

**Gj y q t a r i**

---

**Alush Sinani**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh  
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.